



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “El Bau” SHPK të datës 26.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “El Bau” SHPK të datës 26.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “El Bau” SHPK (tutje “parashtruesi”) me datë 26.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë për lot 6 "Company Eskavatori shpk & Beni Construction shpk" ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që anëtari i GOE sipas parashtruesit nuk ka dorëzuar dëshmitë dokumentare lidhur me certifikatën ISO 9001 2015. Parashtruesi po ashtu ka pretenduar se edhe disa nga tenderuesit tjerë për këtë lot të cilët janë shpallur si të pasuksesshëm është dashur që të eliminohen nga aktiviteti i prokurimit si tenderues të papërgjegjshëm.

Sa i përket pikës së pretendimit ankimor të parashtruesit kundër tenderuesit të rekomanduar, duhet cekur se certifikata ISO 9001 2015 është përcaktuar si kërkesë teknike dhe profesionale në kuptim të nenit 69 të LPP dhe nuk është kërkuar si kërkesë e përshtatshmërisë. Përmes nenit 71 par. 4 të LPP përcaktohet se "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit". Në anën tjetër as për parashtruesin nuk është kontestues faktin që tenderuesi i rekomanduar si grup i operatorëve ekonomik e ka përmbushur kërkesën e tillë pasi që dilemat e parashtruesit ndërliidhen vetëm me njërin anëtar të grupit. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me tenderuesit e tjerë të cilët nuk janë rekomanduar për kontratë, duhet të theksohet që parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP pasi që nuk ka arrij që të dëshmoj asnjë interes material në raport me këto pretendime kundër tenderuesve të pasuksesshëm.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.08.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.